ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër; KOMUNA E PODUJEVËS, RR.ZAHIR PAJAZITI, PODUJEVË, Personi kontaktues:Driton Kiçmari, e-mail:prokurimi.podujeva@rks-gov.net, Telefoni;038 200 41 029, Podujve.

Aktivitetin e Prokurimit: me Numër te e- prokurimit ; 615-24-1543-2-3-6

Sa i përket tenderit për: Sigurimi fizik i objekteve të komunës

ANKESË

1. IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

K.S.F "Major" Sh.a
(Adresa e OE)

Prizren
(Selia)

Adresa elektronike)

(Drejtori)

(Nënshkrimi) (Data)

KSF MAJOR SH.A SECURITY P.N.: 810971433 Prizren Kosova

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Zyra e prokurimit të Komunës së Podujevës ne tekstin e mëtejmë (Autoriteti Kontraktues) me datë 27 shkurt 2024 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; Sigurimi fizik i objekteve te komunës.

Tenderi është publikuar ne Ueb faqen të KRPP-së në;

- Procedurë të kuotimit të çmimeve,

- Numër të e-prokurimit: 615-24-1543-2-3-6
- Kontrate publike për 6 muaj
- Vlera e kontratës; Vlerë e vogël
- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,
- Vlera e parashikuar e kontratës; 6,500.00 €

Afati i fundit për pranim të tenderëve është caktuar me datë 11.03.2024 në ora 13:00 në platformën e e-prokurimit.
Vendi: ne platformën e-prokurimit https://e-prokurimi.rks-gov.net
Takimi për hapjen e tenderëve është bere me datë 11.03.2023 në ora 13:00
Me datë 27.03.2024 AK ka propozuar për shpërblim të kontratës operatorin ekonomik ;Kompaninë e Sigurimeve Fizik "Scorpion" me seli në Ferizaj me vlerë totale të tenderit prej 5,625.00 euro duke publikuar ne platformën e -prokurimit . Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues (B58)
Me date 2 prill 2024 kemi ushtruar kërkesë për rishqyrtim te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se (B58) te datës 27.03.2024.
Me date 4 prill 2024 kemi pranuar Vendimin për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se;
Ju si operator ekonomik , ne ofertën tuaj financiare keni ofruar me çmimin i cili nuk e mbulon pagën bruto te përcaktuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit , përkatësisht çmimi i ofruar nuk korrespondon me deklaratën tuaj se do te respektoni Ligjin e punës pasi qe oferta totale e juaj është 4,953.60 euro.
350x2=700 euro,
700x6=4,200.00 x10% (kontribute) 4,620x18% TVSH del se oferta e juaj do te duhej te ishte mbi 5,451.60 euro, për tu kualifikuar si e përgjegjshme ne raport me kërkesat kualifikuese.
Autoriteti kontraktues për te konstatuar gjendjen reale te ofertës suaj ka autorizuar komisionin profesional për te i rivlerësuar ofertat dhe i njëjti komision bazuar ne dispozitat ligjore te nenit 59 te LPP-se ka konstatuar se oferta e juaj është e pa përgjegjshme "

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] Jo [ ]

Hapja e tenderit është bere përmes platformës elektronike te E-prokurimit ne kohen e caktuar ne Njoftimin për kontratë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

N/A

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I pa kënaqur me Njoftimin mbi rezultatin e tenderit (B58) dhe në pajtim me 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 , parashtrojmë këtë Ankesë kundër;

- **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues (B58)** te datës 27.03.2024 ku, AK ka propozuar për shpërblim të kontratës operatorin ekonomik ;Kompaninë e Sigurimeve Fizik "Scorpion" me seli në Ferizaj me vlerë totale të tenderit prej 5,625.00 euro.
- **Njoftimit për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit** (Letrës standarde për tenderues te eliminuar),
- **Vendimit për refuzimin** e Kërkesës për rishqyrtim te datës 4 prill 2024 te Autoritetit kontraktues –Komuna e Podujevës

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për ri-vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së ri- vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. **Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:**

- Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe
- Nenit 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë

Si dhe

II/ Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.

- Nenit , 41, Tenderët jo-normalisht të ultë

Në vazhdim të kësaj kërkese do t' i argumentojmë pretendimet tona ankimore lidhur me shkeljet e dispozitave të;

1. *Të dispozitave të LPP-se në RK.*

- **Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

Pretendojmë se Komisioni për ri-vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet që të shpërblej me kontrate tenderin e OE; " Kompania e Sigurimit Fizik " Scorpion" -Ferizaj i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 5,625.60 euro, ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6, paragrafin 1. dhe paragrafi 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 dhe 2 te këtij ligji,

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar ne Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim te kontratës, tenderin e OE; ne vlere totale te tenderit prej; 5,625.00 € si dhe bazuar ne tenderin e " K.S. F" Major "sh.a , i cili ka ofertuar me çmim prej; 4,953.00 € shohim qarte se AK, Komuna e Podujevës e ka dëmtuar buxhetin e AK-se dhe taksapaguesve te Kosovës ne vlere prej; 672.00 euro dhe me këtë rast ka bere shkelje te dispozitave te nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 te LPP-se.

- **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Komisioni për ri-vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit si dhe Kriterin për dhënie te kontratës, si dhe bazuar ne Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës te Operatorit Ekonomik" Kompania e Sigurimit Fizik " Scorpion"-Ferizaj i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 5,625.00 euro, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

- **Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,**

Pretendojmë se Komisioni për ri-vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; Kompania e Sigurimit Fizik" Scorpion" me seli në Ferizaj i cili ka ofertuar me çmimin më të larte ne krahasim me tenderuesit tjerë i cili përmban vlerën, prej 5,625.60 euro, ka vepruar ne kundërshtim te nenit 59 duke shkel kriterin për dhënie te kontratës i cili ne dosje te tenderit ka qen i caktuar Çmimi me i ulte i tenderit te përgjegjshëm.
Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni nenin 59 te LPP-se ne momentin kur ka marre vendim për eliminimin e OE: K.S.F "Major"sh.a, i cili ka ofruar dëshmi dokumentare mbi plotësimin e te gjitha kërkesave për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender te cilat jen te përcaktuara ne paragrafin; III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te Njoftimit për kontrate dhe paragrafin III.2.4 (kapaciteti teknik/profesional si dhe ka respektuar kriterin për dhënie te kontratës i cili është Çmimi më i ulte i tenderit te përgjegjshëm..
Ne vazhdim te kësaj kërkese po citoj Kërkesat e AK-se;

Kërkesa ; Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme,
- Një listë të kontratave të realizuara, OE duhet të posedoj licencë mbi ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit fizik të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme – MPB (Licenca duhet të jetë valide sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë nr. 004 L

Evidenca; Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Kopja e Licencës për shërbime themelore të sigurimit - valide
- OE duhet të deklaroj se do të respektoj ligjin e punës
- Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE mbi përmbushjen e specifikimeve teknike te detyrueshme.

Bazuar ne dosjen e tenderit te cilën e ka dorëzuar Parashtruesi i ankesës, shohim se K.S.F. "Major" ka ofruar dëshmitë konforme kërkesave të AK-se dhe atë si në vijim;

Listën të kontratave të realizuara te realizuara ne tri vitet e fundit,
Licencën nga MPB, ne pajtim me Ligjin për shërbimet private te sigurisë ne Kosovë,
Deklaratën se do te respektoj Ligjin e punës , si dhe

Deklaratën për përmbushjen e Specifikimeve teknike te përcaktuara ne aneksin 1 te Dosjes se tenderit.
Bazuar ne paragrafin ; IV.7 VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT, të Dosjes se tenderit Komisioni i Vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit është i obliguar qe;

Kuotimet e çmimit të pranuara me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kërkesave të përcaktuara në këtë dosje të tenderit.
Një kuotim konsiderohet të jetë përgjegjës kur:
a. përputhet në aspektin administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
b. përputhet në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit;
c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Kuotimeve të Çmimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht sqarim mbi Kuotimin e Çmimit të tij/saj. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim.

Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Gabimet e korrigjuara në këtë mënyrë do të jenë të obligueshme për tenderuesin. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Kuotimet e Çmimeve të përgjegjshme do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në këtë dosje të tenderit. Operatori ekonomik i cili ka dorëzuar kuotimin e renditur më se larti sipas rezultatit, do te shpërblehet me kontrate.

Ne Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar AK ka arsyetuar vendimin për eliminim nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se;
K.S.F "Major" në ofertën qe ju keni ofertuar nuk i mbuloni shpenzimet për punëtor. Paga bruto 350 euro siç është kërkuar duke llogaritur kontributet prej 5% te kontributeve te Punëdhënësit dhe 5% te kontributeve te Punëmarrësit duke përfshirë edhe TVSH-ne. Vlera e ofertës është me e vogël dhe ne kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit.
Ndërkaq ne arsyetimin e Vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim AK ka konstatuar;

"Ju si operator ekonomik, ne ofertën tuaj financiare keni ofruar me çmimin i cili nuk e mbulon pagën bruto te përcaktuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit , përkatësisht çmimi i ofruar nuk korrespondon me deklaratën tuaj se do te respektoni Ligjin e punës pasi qe oferta totale e juaj është 4,953.60 euro.

350x2=700 euro,
700x6=4,200.00 x10% (kontribute) 4,620x18% TVSH del se oferta e juaj do te duhej te ishte mbi 5,451.60 euro, për tu kualifikuar si e përgjegjshme ne raport me kërkesat kualifikuese.
Autoriteti kontraktues për te konstatuar gjendjen reale te ofertës suaj ka autorizuar komisionin profesional për te i rivlerësuar ofertat dhe i njëjti komision bazuar ne dispozitat ligjore te nenit 59 te LPP-se ka konstatuar se oferta e juaj është e pa përgjegjshme"
Pretendojmë se arsyetimi i dhënë ne Vendimin për refuzim nuk qëndron sepse;
Ne si operator ekonomik ne momentin kur kemi dorëzuar ne dosjen e tenderit ;Deklaratën e nënshkruar dhe vulosur nga OE mbi përmbushjen e specifikimeve teknike te detyrueshme kemi marre përgjegjësinë se do te i përmbahemi kërkesës se AK-se për pagesën e pagës Bruto për 2 punëtor te sigurimit fizik si dhe kemi marre përgjegjësinë se do te përmbahemi dispozitave te Ligjit te punës i cili është ne fuqi.
Për mos respektim te dispozitave te Ligjit te punës gjate implementimit te kontratës AK-se është kompetent për te menaxhuar ofrimin e shërbimeve te sigurimit fizik ,ndërkaq për mos respektim te Ligjit te punës janë kompetente organet tjera(Inspektorati i Punës dhe ATK).
Autoriteti kontraktues (Komisioni për vlerësim, Komisioni profesional për rivlerësim si dhe ZPP) janë te obliguara qe te i përmbahen dispozitave te LPP-se dhe kërkesave te AK-se te përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit , ne momentin kur e kane lexuar Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike te aneksit 1.

Duke u bazuar ne ate qe u tha me larte pretendojmë se AK ka shkel dispozitat e nenit 59 te Ligjit per Prokurimin Publik me rastin e ri-vlerësimit te tenderit.

- **Nenit 61 , Tenderët Jo-Normalisht te ultë**

Pretendojmë se AK fillimisht përmes rekomandimit të Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit dhe me vone përmes aprovimit te ZPP-se , si dhe Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 61, paragrafi 3, të LPP-së dhe me ketë rast gabimisht ka vlerësuar se çmimi i dhënë ne tender është çmim i cili nuk është ne pajtim me kërkesën e AK-se dhe si rrjedhojë e kësaj ka vlerësuar tenderin në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.
LPP ne RK ne nenin 61 të LPP-së në mënyre detale parasheh kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kualifikohet një tender si tender me çmim Jo –Normalisht të ultë.

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar në ri-vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit , duke vlerësuar gabimisht ofertën e OE te eliminuar K.S.F "Major" Sh.a , si ofertë me çmim Jo-Normalisht të ultë edhe përkundër ofrimit te Deklaratës se nënshkruar dhe vulosur se OE: K.S.F "Major " sh.a , do te i përmbush te gjitha kërkesat e AK-se, sa i përket pagesës se pagave dhe tatimeve te aplikueshme ne Kosove, të dhëna mbi arsyesh mërinë e çmimit të dhëne në ofertën financiare si dhe do te respektoj dispozitat e Ligjit te punës.
Pretendojmë se oferta financiare, ka qen ofertë reale dhe e bazuar në çmimet reale në tregun e e punës se Kosovës.

Shkeljet e pretenduara të;

II/ Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.

➢ Neni , 41, Tenderët jo-normalisht të ultë

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues (fillimisht Komisioni për vlerësim, pastaj Komisioni për rivlerësim profesional dhe ZPP gjate shqyrtimit te Kërkesës për rishqyrtim) ka dështuar në zbatimin e nenit 41 të e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.
Nëse i referohemi nenit 41.1 të kësaj Rregulloreje shohim se si duhet te veprohet, kur AK konsideron se një oferte e dorëzuar duhet te trajtohet si oferte e pa realizueshme gjate implementimit te kontratës dhe me çmim qe sipas LPP-se dhe Rregullores se Prokurimit publik trajtohet Çmim-normalisht i ulte.
Ne nenin 41 te kësaj Rregulloreje përcakton konceptin e tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.
Bazaar ne paragrafin 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulet, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë ***inter partes*** me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët.
Bazuar ne platformën e -prokurimit nuk kemi vërejtur se AK, i është drejtuar OE me Letrën standarde për tenderues jo-normalisht te ulte siç e përcakton LPP dhe legjislacioni dytësor si dhe obligimin tjetër ligjor qe te njoftohet KRPP-ja.
Ne këtë situate AK është i obliguar qe; të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, si dhe ta i përmbahet kushteve te përcaktuara si ne vijim;

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Në baze te Raportit të vlerësimit të tenderit, dhe Vendimit mbi dhënien e kontratës shohim se në ketë tender kanë marrë pjese 4 tenderues.

1. Kompania e Sigurimit Fizik, "Major" sh.a , i cili ka ofertuar me çmimin total ne vlere prej 4, 953.60 euro ,
2. " Kompania e Sigurimit Fizik " Scorpion" - Ferizaj i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 5,625.00 euro,
3. " Kompania e Sigurimit Fizik " Jaguar- Prizren i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 4,953.60 euro dhe
4. " Kompania e Sigurimit Fizik " Besa Security" i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit; ne vlere prej 5,664.00 euro

Autoriteti kontraktues është dashur te veproj ne pajtim me nenin 41.4 te Rregullores i cili përcakton me sa vijon;

41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë **shpjegime** në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së

Pretendojmë se AK nuk ka baze ligjore për te trajtuar ofertën me çmim jo normalisht te ulte konforme nenit 41.3 te Rregullores qe ndërlidhet me nenin 61 te LPP-se.
Ne baze te formulës çmimi i Kompanisë se Sigurimit fizik Major nuk është 30 % me i ulte se çmimi mesatar i tenderëve te përgjegjshëm qe janë me shume se tre (ne pikëpamje te plotësimit te kushteve formale administrative) .
Çmimi mesatar i tenderëve te përgjegjshëm është 5,299.20 euro.
4 ofertues janë te përgjegjshëm administrativisht.
Çmimi i OE; K.S.F "Major nuk është 10% me i ulte se çmimi i tenderit te dyte.

Me fjale te tjera nuk ka baze ligjore për tu trajtuar si oferte e pa përgjegjshme ne kuptim te arsyetimit se çmimi i dhënë ne vlere prej 4,953.60 euro për pagesën e dy punëtoreve me page bruto prej 350.00 euro për te i mbuluar shpenzimet për pagesën e kontributeve dhe tatimeve te aplikueshme ne Kosove, dhe nuk ka baze ligjore për tu eliminuar nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit.
Bazuar ne Njoftimin për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit si dhe bazuar ne dispozitat e nenit 41 te Rregullores për Prokurimin Publik qe ndërlidhet me nenin 61 te LPP-se pretendojmë se AK gjate procedurës se vlerësimit ekzaminimit ,krahasimit te tenderëve ka vepruar ne kundërshtim te plote me dispozitat e LPP-se, Rregullores për Prokurimin Publik dhe dispozitat e Dosjes se tenderit.

Duke pasur parasysh këto fakte i propozoj Panelit Shqyrtues te OSHP –se qe pas aplikimit te dispozitave te LPP-se qe kane te bëjnë me nenin 59 qe ndërlidhet me nenin 61 te LPP-se te marre këtë;

VENDIM

- **TE APROVOJ,** Ankesën të parashtruar nga OE; K.S.F "Major" si të bazuar,
- **TE ANULOJ** , Njoftimin mbi Vendimin e AK-se te datës 27 mars 2024 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblim te kontratës OE: Kompania e Sigurimit Fizik " Scorpion" me seli në Ferizaj i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit më të larte ne krahasim me tenderuesit tjerë i cili përmban vlerën prej 5,625.60 euro,
- **TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM**, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes te cilat janë te përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit ne pajtim me LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik te vitit 2023.

Mbetemi me shpresë se Ankesa e jone do të shqyrtohet, pozitivisht.
Me nderime,
K.S.F" Major" sh.a
Drejtori

---

7. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani dëme materiale ne vlere prej 500 euro për përgatitjen e Kërkesës për rishqyrtim dhe Ankesës ne OSHP.

8. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin mbi vendimin e AK-se " (B58)
c) një kopje te" Kërkesës për rishqyrtim te datës 2.04.2024 ".
d) një kopje te "Vendimit për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim te Autoritetit kontraktues te datës 04.04.2024"
f) një kopje të "Procesverbalit të hapjes publike të tenderëve".